



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 574/prot.

B.Curri, me, 10.12.2025

VENDIM

Nr. 74 Date **05.12.2025**

**PËR NJË SHITESË NË LISTËN E INVESTIMEVE PRIORITARE TË BASHKISË
TROPOJË MIRATUAR ME VENDIM NR.59 DATE 30.12.2019 (I NDRYSHUAR)**

Këshilli Bashkiak Tropojë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 05.12.2025, mbështetur në nenin 8 pika 2 ; nenit 9 pika 1/1 shkronja “b”, nenit 34 pika 3; nenit 54 ; nenit 55 pika 6 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr.44/2015 , date 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.10296 date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) , VKB nr.59 date 30.12.2019 “Per Miratimin e Listes Prioritare të Investimeve për të cilat kërkohen financime për vitin 2020” (i ndryshuar); Kërkesës së paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për shtesë në listën e objekteve prioritare të Bashkisë Tropojë për objektin: **Rruga “Unaza e Bjeshkëve”** , Këshilli Bashkiak Tropojë pas diskutimeve :

VENDOSI

1. **Për një shtesë në Vendimin nr.59 datë 30.12.2019 të Këshillit të Bashkisë Tropojë “Per Miratimin e Listes Prioritare të Investimeve për të cilat kërkohen financime për vitin 2020”** i ndryshuar; për objektin **“Rruga “Unaza e Bjeshkëve”** për të cilin Bashkia Tropojë do aplikojë për përfitim investimesh përpara zhvillimit të procedurës.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë
3. Ky vendim hyn sipas nenit 55 pika 6 te ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

Shpallur me 10.12.2025, Miratuar me 12 vota, 13 Vota Pro , 0 Vota Kundër, 0 Vota Abstenim.

SEKRETARI
Ergent GJONGECAJ

KRYETAR
Arbër ÇAKRAJ
Në mungesë dhe me porosi
ZV.KRYETAR
Besjan GJONAJ

